

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 6445/3, datë 9.1.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE ZYRTARE QË DO TË ZBATOHEN NGA AGJENCIA
E TRAJTIMIT TË PRONAVE, PËR SHËRBIMET E OFRUARA PREJ SAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të neneve 26, pika 6 dhe 28, pika 5, të ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të pikës 9, kapitulli II, të vendimit nr. 222, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj”, si dhe të vendimit nr. 432, datë 28.6.2006 të Këshillit të ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, me propozim të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave,

URDHËROJNË:

1. Agjencia e Trajtimit të Pronave, gjatë procedurave për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, për të gjitha shërbimet e ofruara prej saj, zbaton tarifat financiare si më poshtë vijon:

Emërtimi i shërbimit të ofruar	Tarifat në lekë
a) për paraqitjen e kërkesës dhe hapjen e dosjes së re të njohjes dhe kompensimit	3000
b) kërkesë për kompensim	2000
c) kërkesë për kompensim në vlerë për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtime informale	2000
d) kërkesë për tjetërsimin e sipërfaqes oborr në përdorim	3000
e) kërkesë për lëshim kopjeje dokumentacioni të administruar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave:	
- deri në 100 fletë	20 lekë/fletë
- mbi 100 fletë	3000 lekë

2. Fondi i krijuar nga zbatimi i këtyre tarifave derdhet 100% në buxhetin e shtetit.

3. Urdhri nr. 8867/2, datë 28.12.2006, “Për miratimin e tarifave zyrtare që do të zbatohen nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për shërbimet e ofruara prej saj”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

MINISTRI I FINANCIVE
Arben Ahmetaj

